

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi - Përdhunoj 32-vjeçaren dhe i plagosi babanë, gjykata lë në burg dajën e Zegjine Çaushit
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/917282/perdhunoi-32-vjecaren-dhe-i-plagosi-babane-gjykata-l-e-ne-burg-dajen-e-zegjine-caushit/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 09:06:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:54:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	74b9cdb8c952f410cc3e72651ac4093c4cfaa0932df722499aa4c5b840c5fa5c
TEKSTI	bdf92d12221a6329a1758c24bbe579717de764fea8c0f7f0d2f741d01209ef70
PAMJA	aad78c3b1e8e2a80d3f4ac0e673ec489aa50c700771c72a2bbd52b732f11dce0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d3f9cd57f39f6845f70eca5f82c286fc3e04f5ee68a61c02f8b1d1d8fb4899b2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	554d51ffe1583614fc44621ae1478dd51416957b577076ef62782afd72e64dbf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d3f9cd57f39f6845f70eca5f82c286fc3e04f5ee68a61c02f8b1d1d8fb4899b2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA
Tradhtia që s'e panë tu ardhë

LAJMI I FUNDIT

LIVE - Sot seancë plenare dhe protesta



më të lexuarat

'Rama jepe dorëheqjen!' Tiranë zgjohet me protesta, policia shoqëron 7 protestues

Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve

Përplasja me armë/ Alket Rizai në kërkim, sot duhej të paraqitej në burg pasi kishte marrë leje

Si u rrëzua banda shqiptare e trafikantëve nga imazhi i një luani i krijuar me IA

Trafikanti shqiptar i shpëton burgut: Partnerja ka depresion dhe dhimbje kronike

Alarmi për bombë në një shkollë në Tiranë rezulton fals, arrestohet një person/ EMRI



Përdhunoi 32-vjeçaren dhe i plagosi babanë, gjykata lë në burg dajën e Zegjine Çaushit

10:54, 17/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Gjykata e Fierit ka vendosur masën e sigurisë "arrest me burg" për Bledar Bakajn, dajën e deputetes së PS, Zegjine Çaushit, pas seancës së zhvilluar këtë mëngjes.

Seanca për vlerësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit u zhvillua nën drejtimin e gjyqtarës Bora Shaholli, ndërsa çështja u ndoq nga prokurorja Oljana Gjergjeji.

Pas shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë dhe materialeve të paraqitura gjatë seancës, gjykata vendosi që Bakaj të qëndrojë në masën e sigurimit "arrest me burg".

Bledar Bakaj dyshohet se ka mbajtur peng dhe ka përdhunuar një 32-vjeçare nga Roskoveci, ndërsa plagosi babain e saj me mjete prerës.

Ngjarja dyshohet se ka ndodhur pas shkeljes së një urdhri mbrojtjeje të vendosur nga gjykata në favor të ish-bashkëjetueses së Bakajt.

Sipas hetimeve paraprake, 52-vjeçari ka shkuar në banesën ku ndodhej ish-bashkëjetuesja e tij, ku më pas ka ndodhur konflikti.

Në Komisaratin e Fierit, Bakaj ka mohuar akuzat për abuzim ndaj 34-vjeçares dhe ka deklaruar se do të flasë para gjykatës.

Mbi 52-vjeçarin rëndojnë akuzat për veprat penale "plagosja e rëndë me dashje" dhe "veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER

NJOFTIM PËR MEDIA

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier e përbërë nga:

GJYQTARË: BORA SHAHOLLI

Sot më datë 17.09.2026, mori në shqyrtim në seancën gjyqësore kërkesën që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, përfaqësuar nga Prokurori Olina Gjergjeji.

KUNDËR: Personi nën hetim **B.B.**, mbrojtur nga av. Shkëlqim Beqiraj dhe av. Klaudio Dhima, të zgjedhur me deklarim në seancë.

I DYSHUAR: Për veprat penale "Plagosja e rëndë me dashje", parashikuar nga neni 88/2 i Kodit Penal dhe "Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës", parashikuar nga neni 321/2 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Vlefësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit **B.B.**.
Caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 228, 229, 230, 224/1, 251, 252, 258 dhe 259, të K.Pr.Penale.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, në mbështetje të neneve 228-230, 238, 252, 245 dhe 259, të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Vlefësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit **B.B.**
2. Caktimin si masë sigurimi personal shtrënguese ndaj personit nën hetim **B.B.**, atë të "Arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.
3. Urdhërohet Policia Gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Fier, sot, më datë 17.09.2026.

**GJYQTARË
BORA SHAHOLLI**

Roskovec/ Daja i Zegjine Çaushtit plagosi me çekiç ish-vjehrrin e tij

Arrestohet në flagrancë një efektiv policie, dy të tjerë hetohen në gjendje të lirë

I dhunojnë dhe arrestojnë/ Policia prangos 12 protestues se thirrën: Rama jepe dorëheqjen

© SYRI.net

Lexo edhe:



Dyshime për abuzime me pronat në Fier, pranga dy ish-drejtorëve të ASHK-së, specialisti dhe përfituesi



Përdhunoi 32-vjeçaren dhe i plagosi babain! Sot masa e sigurisë për dajën e Zegjine Çaushtit



Shtyhet seanca ndaj Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit, mungoi anëtarë i trupit gjykues

TË NGJASHME



Tre të rinj plagosen me thikë në shëtitoren e Sarandës, dy prej tyre vëllezër! 2 të arrestuar një në kërkim (EMRAT)



E rëndë në Tiranë! Tezja dhe kushëriiri abuzojnë seksualisht me 12-vjeçaren, në telefonin e të miturës u gjetën video të rënda pornografike



EMRAT - Detaje nga ngjarja në Durrës/ Plagoset avokatit, policia në kërkim të autorit



VIDEO/ Plagosje me armë zjarri në Durrës



Arkitekti Olsi Eftimi ka dhënë deklarime në SPAK lidhur me hetimet për dosjen 'Balluku'



Vijojnë kontrollet në burgje, sekuestrohet një tjetër telefon në gëlinë e të dënuarit në Durrës



Ilir Meta kërkoi pezullimin e afateve të paraburgimit, GJKKO shtyn vendimin!

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIËS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione: info@syri.net ose redaksia@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.